



Nr. 07/2018

Datë: 21.09.2018

Bazuar në nenin 4 paragrafi 3 nënparagrafi 3.1 dhe nenin 17 të Ligjit Nr. 05/L -042 për Rregullimin e Shërbimeve të Ujit, i shpallur në Gazetën Zyrtare Nr. 4/2016 datë 14.01.2016, Rregulloren nr. 05/2016 për Licencimin e Ofruesve të Shërbimeve të Ujit në Kosovë, si dhe kërkesën për përtëritjen e licencës me nr. 561 dt. 24.08.2018 të KRU 'Hidromorava', Drejtori i Autoritetit Rregullator për Shërbimet e Ujit (Autoriteti), me dt. 21.09.2018 merr këtë:

### VENDIM

#### Për përtëritjen e licencës të ofruesit të shërbimeve

1. Aprovohet kërkesa për përtëritje të licencës së shërbimit të KRU 'Hidromorava' me nr. 561 datë 24.08.2018,
2. Autoriteti lëshon Licencë për Shërbime dhe dokumentin e Kushteve të Licencimit për KRU 'Hidromorava', e cila është valide për periudhën 25.09.2018 - 10.09.2026.
3. Obligohet KRU 'Hidromorava' që të i përmbahet dispozitave ligjore të parapara me Ligjin për Rregullimin e Shërbimeve të Ujit dhe Rregulloren për Licencimin e Ofruesve të Shërbimeve të Ujit në Kosovë, si dhe Kushteve të Licencës (shtojca e Licencës së Shërbimeve).
4. Autoriteti kontrollon zbatimin e kushteve të licencës së shërbimit nga Ofruesi i licencuar dhe e vlerëson nivelin e zbatueshmërisë së tyre sipas legjislacionit në fuqi. Autoriteti mund të ndryshojë, plotësojë ose zëvendësojë cilat do kushte të caktuara për Licencë për Shërbime konform legjislacionit në fuqi.
5. Në rast të mos zbatimit të kushteve të licencës Autoriteti do të veprojë lidhur me pezullimin dhe revokimin e licencës, si dhe masave tjera sanksionuese ndaj të licencuarit sipas legjislacionit në fuqi.
6. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

**Këshillë juridike:** Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në Komisionin Shqyrtues në afat prej 30 (tridhjetë) ditë kalendarike, nga dita e pranimit të këtij vendimi.

*T'i dërgohet;*

*1x Arkivit të ARRU*

*1X Të gjitha Dep. të ARRU dhe Njësisë për Inspektim*

*1x Kryeshefit Ekzekutiv KRU 'Hidromorava'*

